



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E FINANCËS DHE PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT

Nr. 506 Prot

Himarë, më 19.01.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim dhe miratim raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Himarë.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Sekretarit të këshillit Z. Zaho Dedi ✓

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtitë e pushtetit vendor”i ndryshuar, VKB nr.61 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe kalendarit të përgatitjes së PBA 2027-2029 dhe buxheti vjetor 2027”, VKB nr.59 datë 17.11.2025 “ Për ndryshimet e “Paketës fiskale të vitit 2026” të Bashkisë Himarë, të ndryshuar me VKB nr. 54 datë 25.11.2021, ndryshuar me VKB n.34 datë 27.11.2024”, ju vendosim në dispozicion dokumentin dhe relacionin për raportimin e vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Himarë.

Faleminderit për bashkëpunimin.

KRYETAR

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E FINANCËS DHE PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT

Nr. 506/11 Prot

Himarë, më 19.01.2026

PROJEKTVENDIM

NR. 1 DT. 19.01/2026

**“ PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET
AFATMESME TË TË ARDHURAVE”**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtitë e pushtetit vendor”i ndryshuar, VKB nr.61 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe kalendarit të përgatitjes së PBA 2027-2029 dhe buxheti vjetor 2027”, VKB nr.59 datë 17.11.2025 “ Për ndryshimet e “Paketës fiskale të vitit 2026” të Bashkisë Himarë, të ndryshuar me VKB nr. 54 datë 25.11.2021, ndryshuar me VKB n.34 datë 27.11.2024”, ju vendosim në dispozicion dokumentin dhe relacionin për raportimin e vlerësimit dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Himarë.

VENDOSI:

1. Të miratohet raporti për vlerësimit dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave 2027-2029 të Bashkisë Himarë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Himarë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E FINANCËS DHE PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT

Nr. 506/2 Prot

Himarë, më 19.01.2026

Lënda: Relacion shpjegues mbi raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Himarë.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

KËTU

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtisë e pushtetit vendor”i ndryshuar, VKB nr.61 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe kalendarit të përgatitjes së PBA 2027-2029 dhe buxheti vjetor 2027”, VKB nr.59 datë 17.11.2025 “ Për ndryshimet e “Paketës fiskale të vitit 2026” të Bashkisë Himarë, të ndryshuar me VKB nr. 54 datë 25.11.2021, ndryshuar me VKB n.34 datë 27.11.2024”, ju vendosim në dispozicion dokumentin dhe relacionin për raportimin e vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Himarë.

Ky relacion ka për qëllim informimin e Këshillit Bashkiak mbi performancën financiare të viteve paraardhëse, vlerësimin e vitit aktual buxhetor 2026, si dhe analizimin e projeksioneve për vitet 2027–2029, duke evidentuar politikat fiskale të ndjekura, risqet e mundshme dhe masat për menaxhimin e tyre.

✚ Analiza e të ardhurave për periudhën 2024–2025

Gjatë vitit buxhetor 2024, totali i të ardhurave të Bashkisë Himarë është realizuar në vlerën 2,042,437 lekë, ndërsa për vitin 2025 ky total arrin në 3,153,212 lekë. Kjo përfaqëson një rritje absolute prej 1,110,775 lekësh dhe një rritje relative prej rreth 54.3%.

➤ Struktura e të ardhurave në këto dy vite paraqitet si më poshtë:

Të ardhurat nga burimet e veta janë realizuar në masën 684,305 lekë në vitin 2024 dhe 1,365,877 lekë në vitin 2025, duke shënuar një rritje prej 681,572 lekësh ose rreth 99.6%. Pësia e këtij zëri në totalin e të ardhurave rritet nga rreth 33.5% në vitin 2024 në rreth 43.3% në vitin 2025, çka tregon një përmirësim të ndjeshëm në kapacitetet e gjenerimit të të ardhurave vendore.

Transferta nga buxheti i shtetit janë realizuar në vlerën 280,412 lekë në vitin 2024 dhe 306,109

lekë në vitin 2025, me një rritje prej 25,697 lekësh ose rreth 9.2%. Pesha e këtij zëri në totalin e të ardhurave mbetet relativisht e qëndrueshme, duke varionuar nga 13.7% në 9.7%, duke u konsideruar si burim mbështetës, por jo determinant për rritjen buxhetore. Trashëgimia nga viti i shkuar përbën një zë të rëndësishëm të të ardhurave, me vlerë 1,077,720 lekë në vitin 2024 dhe 1,481,226 lekë në vitin 2025, duke shënuar një rritje prej rreth 37.5%. Ky zë zë mbi 52% të totalit të të ardhurave në vitin 2024 dhe rreth 47% në vitin 2025, duke evidentuar një varësi ende të konsiderueshme nga fondet e pashpenzuara të viteve të mëparshme.

Në tërësi, periudha 2024–2025 karakterizohet nga një fazë tranzitore në menaxhimin financiar, ku krahas përdorimit të fondeve të trashëguara vihet re një rritje e ndjeshme e të ardhurave nga burimet e veta.

Analiza e të ardhurave për vitin 2026

Për vitin buxhetor 2026, totali i të ardhurave të Bashkisë Himarë është planifikuar dhe parashikuar në vlerën 7,552,715 lekë, duke shënuar një rritje shumë të lartë prej 4,399,503 lekësh krahasuar me vitin 2025, ose rreth 139.6%.

Të ardhurat nga burimet e veta për vitin 2026 parashikohen në masën 4,222,200 lekë, çka përfaqëson një rritje prej mbi 209% krahasuar me vitin 2025. Pesha e këtij zëri në totalin e të ardhurave arrin në rreth 56%, duke e kthyer atë në burimin kryesor të financimit të buxhetit vendor. Transferta nga buxheti i shtetit parashikohen në vlerën 342,096 lekë, me rritje të moderuar, por me peshë të reduktuar në vetëm 4.5% të totalit të të ardhurave.

Trashëgimia nga viti i shkuar për vitin 2026 parashikohet në vlerën 2,988,419 lekë, duke zënë rreth 39.6% të totalit të të ardhurave, çka reflekton përdorimin e fondeve të akumuluar për mbështetjen e zgjerimit të aktiviteteve buxhetore.

Ndryshimet të cilat janë pasqyruar në paketën fiskale të vitit 2026:

NDRYSHIMI 1 – TAKSA MBI NDËRTESAT

1. Taksa mbi ndërtesat (sipërfaqja e prezumuar)

Analiza e situatës aktuale

Në territorin e Bashkisë Himarë ekziston një numër i konsiderueshëm ndërtesash për të cilat identifikohet ekzistenca por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja reale e njësisë pronësore apo ndërtesës. Mungesa e të dhënave krijon pabarazi tatimore dhe ulje të të ardhurave, krijon evazion fiskal ose subjektivizëm të theksuar.

Problematikat e konstatuara

- Mospërputhje mes deklarimeve dhe sipërfaqeve reale, në rastin më të mire;
- Ndërtesa të vjetra, të privatizuara ose me dokumente të mangëta që nuk lejojnë të arrihet në përcaktimin e sipërfaqes së saktë të ndërtesës apo njësisë pronësore;
- Kosto dhe kohë e lartë verifikimi ose pamundësi në faturim;
- Disbalanca në faturim dhe arkëtim mes tatimpaguesve të njëjtë.

Arsyetimi i ndryshimit

Aplikim i sipërfaqes së prezumuar 100 metër katror sipërfaqe per njesi pronesore, për ndërtesat per banim dhe 70 metër katror për ndërtesat per banim te ndertuara para vitit 1992, bazuar ne ligjin nr.7652, dt.23.12.1992 “Per privatizimin e banesave shtetere”, të ndryshuar, krijon standard të unifikuar për administrimin tatimor. Masa ul subjektivizmin, rrit drejtësinë fiskale, shmang abuzimet me deklarimet nën normë, shmang konfliktet administrative dhe rrit parashikueshmërinë e të ardhurave.

Efektet në administrim dhe financa

- Rritje të të ardhurave nga taksa për ndërtesat;
- Shmang subjektivizmin dhe lehtëson punën e agjentit tatimor;
- Ulje e kostove të verifikimit;
- Rritje e transparencës tatimore.

2. Taksa mbi ndërtesat (lejet e papërfunduara)

Gjendja aktuale

Një numër lejesh ndërtimi nuk përfundojnë brenda afateve të parashikuara, duke krijuar struktura ndërtimore që jo vetëm mbajnë “peng” zhvillimin urban dhe estetik të territorit por në të njëjtën kohë devijojnë planin e të ardhurave për bashkinë nga minimumi taksa e ndërtesës.

Qëllimet e ndërhyrjes

- Nxitja e përfundimit të punimeve;
- Reduktimi i strukturave ndërtimore që tejkalojnë afatet e lejes së ndërtimit;
- Vendosja e disiplinës fiskale duke penalizuar në këtë mënyrë vonesat në realizimin e planit të të ardhurave të parashikuara bazuar në afatet e lejes së ndërtimit.

Arsyetimi i ndryshimit

Aplikimi i 30% të taksës së ndërtesës për ndërtesat e pajisura me leje ndërtimi, por që nuk kanë arritur të përfundojnë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi, shërben si mekanizëm korrektues për subjektet që nuk zbatojnë detyrimet e marra. Masa kompenson kostot publike të territorit të zënë, shmang kaosin ndërtimor dhe përpiqet të ndergjegjësojë zhvilluesit dhe ndërtuesit. Ky ndryshim në mënyrën e taksimit për taksën e ndërtesës përmirëson imazhin urban, rrit të ardhurat dhe synon të ul numrin e objekteve që janë në tejkalim te lejeve të ndërtimit.

Efektet afatshkurtra dhe afatgjata

- Përfundim më i shpejtë i ndërtimeve;
- Përmirësim i pamjes urbane dhe ulje e ndotjes në territorin e bashkisë;

- Rritje të të ardhurave nga taksa për ndërtesat si dhe realizim i planit të të ardhurave në një masë më të madhe.

NDRYSHIMI 2 – TAKSA E FJETJES

Analiza e tregut lokal

Vilat me qira gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme sezonale, por kontributi i tyre fiskal është dukshëm më i ulët se strukturat e tjera akomoduese për të mos thënë është afër zeros. Në situatën aktuale kur ndërtimi i vilave, për banim ose qiradhënie, në territorin e bashkisë Himarë është në rritje eksponenciale është e domosdoshme të paraprijmë edhe nga pikëpamja fiskale.

Pabarazitë e evidentuara

- Fitime të larta, taksim minimal;
- Ngërç metodologjik për faturim të saktë të vilave të destinuara për qiradhënie;
- Konkurrencë jo e drejtë me hotelet, bujtinat dhe kategori të ngjashme me to.

Arsyetimi i ndryshimit

Vendosja e taksës së fjetjes 160 lekë në natë, për vilat, krijon balancim të drejtë fiskal midis formave të ndryshme të akomodimit. Në konceptin praktik një formë e tillë taksimi prezumon të paktën katër dhoma fjetjeje në cdo vilë dhe arrin deri diku të vendos një shenjë barazimi me mënyrën si taksohen struktura të ngjashme. Vilat përfitojnë intensivisht nga infrastruktura publike dhe duhet të kontribuojnë proporcionalisht. Masa rrit formalizimin, përmirëson transparencën në deklarime dhe përputhet me politikat kombëtare për turizmin elitare. Ekonomikisht është e përballueshme dhe nuk dëmton konkurrueshmërinë e tregut turistik.

Pritshmëritë për administrimin

- Tejkallim i ngërçit në metodologjinë e faturimit;
- Balancim fiskal midis strukturave akomoduese;
- Të ardhura shtesë nga taksa e fjetjes në hotel por edhe pararendje për trendin e ri të qiradhënies së vilave për turizëm elitare.

NDRYSHIMI 3 – TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Analiza e situatës aktuale

Bashkia Himarë ka pësuar rritje të ndjeshme të aktiviteteve ndërtimore, në veçanti në struktura banimi, tregëtare dhe turistike. Niveli aktual i taksës së ndikimit për kategori të caktuara nuk reflekton më presionin që zhvillimet e reja ushtrojnë mbi infrastrukturën publike, përdorimin e rrjeteve rrugore, kanalizimeve dhe shërbimeve komunitare. Në raste të strukturave miks, kategorizimi aktual krijon mungesë drejtësie fiskale.

Problematikat e identifikuara

- Nivele taksimi të pandiferencuara midis ndërtimeve turistike dhe atyre jo-turistike;
- Strukturat “mikse” shmangin kategorizimin e drejtë, duke paguar taksë më të ulët;
- Përdorim intensiv i infrastrukturës publike nga objektet turistike;
- Nevoja për fonde shtesë për të përballuar zhvillimin urban.

Arsyetimi i ndryshimit

Rritja e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë:

- Nga 7% në 8% për ndërtime banimi, administrative, tregtare e shërbimi, jo për turizëm.

Ky ndryshim përafron taksimin me ndikimin real ekonomik dhe mjedisor të ndërtimit, siguron financim real për investime publike, vendos drejtësi fiskale dhe harmonizohet me praktikën e bashkive të tjera turistike.

Pritshmëritë dhe efektet

- Rritje të të ardhurave për infrastrukturë;
- Përmirësim të kapaciteteve për rrugë, kanalizime dhe hapësira publike;
- Shmangie e abuzimeve në kategorizimin e ndërtimit;
- Zhvillim i qëndrueshëm urban.

NDRYSHIMI 4 – TARIFA PËR DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE

Vendosja e një tarife të re

Bashkia Himarë nuk ka pasur më parë një tarifë të dedikuar për depozitimin e mbetjeve inerte, duke lejuar krijimin e problematikave mjedisore dhe territoriale. Vendosja e tarifës 1000 lekë/m³ per subjektet dhe 500 leke/m³ per individet synon krijimin e një mekanizmi të drejtë për administrimin e mbetjeve.

Problematikat e konstatuara

- Hedhje e pakontrolluar e inertëve në zona natyrore dhe hapësira publike;
- Kosto të larta për pastrim dhe rehabilitim;
- Mungesë kontrolli të sasisë së mbetjeve të prodhuara;
- Mungesë mekanizmi për përgjegjësim individual.

Arsyetimi i ndryshimit

Aplikimi i tarifës dhe pajisja e çdo subjekti me mandat–pagesë siguron kontroll të sasive të mbetjeve, disiplinim të praktikave ndërtimore, mbrojtje të hapësirave publike dhe mbulim të kostove të menaxhimit.

Efektet e pritshme

- Reduktim i ndotjes vizuale dhe mjedisore;
- Burime financiare të qëndrueshme;
- Përmirësim i cilësisë së jetesës dhe standardeve turistike.

NDRYSHIMI 5 – TARIFA E PASTRIMIT

1. Tarifa e pastrimit për familjarët

Situata aktuale dhe sfidat

Tarifa aktuale e pastrimit për familjarët, e aplikuar në nivelin 50% të tarifës së plotë, nuk mbulon më kostot reale të pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve, sidomos gjatë sezonit turistik kur volumi i mbetjeve rritet ndjeshëm. Jemi dëshmitarë të faktit që gjatë sezonit patëm me dhjetra raste të evidentimit të mos depozitimit të mbetjeve familjare në vendet e përcaktuara për këtë qëllim duke shtuar në mënyrë të panevojshme ndotjen por edhe kostot e këtij shërbimi aq jetik.

Nevoja për rishikim tarifor

- Nevoja e lartë për të ruajtur dhe përmirësuar cilësinë e shërbimit gjatë pikut të sezonit;
- Presion i lartë turistik që gjeneron më shumë mbetje;
- Mospërputhje midis të ardhurave dhe kostove reale;
- Mbulim i plotë i kostove të shërbimit të pastrimit për zërin familjarë.

Arsyetimi i ndryshimit

Vendosja e tarifës së plotë 1,800 lekë në vit synon të balancojë kostot reale të shërbimit të pastrimit me të ardhurat aktuale. Tarifa e aplikuar në vitin e shkuar me një ulje prej 50% për kategorinë familjarë krijon defisit financiar të pamjaftueshëm për funksionimin normal të shërbimit. Ndërkohë, tarifa që kërkohet të paguhet nga cdo familje për vitin 2026 është vetëm 150 lekë në muaj. Përjashtimi i kategorive të mbrojtura ruan barazinë sociale dhe mbron grupet vulnerabël. Duhet theksuar se në këte rast shtresat e mbrojtura do të kenë detyrim zero për tarifën e pastrimit në të njëjtin vit ushtrimor.

Ndikimet financiare dhe operative

- Mbulesë reale të kostove;
- Përmirësim i cilësisë së shërbimit;
- Më shumë burime për sezonin ardhur nga zëri familjarë;
- Higjienë publike më e qëndrueshme.

2. Tarifa e pastrimit për kantieret e ndërtimit

Problemi i mbetjeve inerte dhe kantierëve të ndërtimit të veprave publike

Kantieret gjenerojnë sasi të mëdha mbetjesh inerte që kërkojnë menaxhim të specializuar dhe kosto të larta për pastrim, transport dhe depozitim. Deri tani janë favorizuar me të drejtë të gjitha subjektet që ngrinin kantiere ndërtimi për realizimin e veprave publike të financuara nga buxheti i shtetit apo i bashkisë por në kushtet aktuale kur niveli i tyre është shtuar shumë jo vetëm në numra por edhe në vlera, kjo masë përjashtimore gjykohen e panevojshme.

Praktikat problematike në terren

- Subjekte që fitojnë shumë nga punët publike por edhe ndotin shumë;
- Rritje e kostove për mbulim nga bashkia në raport me subjektet e përjashtuar;
- Domosdoshmëri për të mbuluar kostot e shërbimit të pastrimit.

Arsyetimi i ndryshimit

Aplikimi i tarifës për subjekte deri dhe te përjashtuara rrit barazinë në taksim . Masa vendos përgjegjësi të qartë, ul ngarkesën financiare mbi bashkinë . Përjashtimi i veprave publike nën 10 milion lekë mbron investimet e vogla publike dhe nuk dekurajon konkurrentët ne procedura.

Përfitimet buxhetore dhe mjedisore

- Mbulim real të kostove;
- Mjedis i pastër dhe i kontrolluar;
- Reduktim i hedhjeve të paligjshme;
- Shërbim më efikas në zonat me ndërtime;

NDRYSHIMI 6 - TARIFA PËR HAPËSIRAT PUBLIKE

1. Tarifa për zënien e hapësirës publike (vijë bregdetare)

Përmbajtja e ndryshimit

Ndryshimi konsiston në rishikimin e tarifës ditore dhe nënkomponentëve (gjelbërim, ndriçim, pastrim) për subjektet që shfrytëzojnë hapësirë publike në vijën bregdetare për veprimtari biznesi në stacione plazhi apo bare në plazh, në mënyrë strikte pa përfshirë subjekte të tjera.

Analiza e situatës aktuale

Vija bregdetare përfaqëson zonën me ngarkesën më të lartë turistike në territorin e Bashkisë Himarë. Diferencimi ketu synon te lehtësoje nga pagesa e dubluar subjektet qe nuk perfshihen ne aktivitetet te drejtperdrejte ne plazhe sic jane stacionet e plazhit apo baret ne plazh.

2. Tarifa e shërbimit për plazhet publike

Përshkrimi i rregullimit

Tabela e re përcakton tarifën 300 lekë për vend/cadër në plazhet publike të Njësisë Himarë dhe 200 lekë të Njësisë Lukovë, duke diferencuar vlerën dhe duke qartësuar mënyrën e faturimit për përdoruesit.

Arsyetimi teknik

Vendosja e tarifës së unifikuar bazohet në:

- rritjen e ndjeshme të kostove të pastrimit, menaxhimit dhe shërbimeve mbështetëse në plazhet publike;
- fluksin shumë të lartë turistik gjatë sezonit të verës;
- nevojën për të garantuar standarde të qëndrueshme të higjienës dhe sigurisë;
- hartimin e një strukture tarifore të thjeshtë, të lexueshme dhe të aplikueshme në mënyrë të njëtrajtshme.

Argumentimi financiar

Tarifa është përcaktuar mbi analizën kosto-përfitim dhe përfaqëson nivelin minimal të nevojshëm për të mbuluar:

- shërbimet e përditshme të pastrimit;
- menaxhimin e territorit të plazhit;
- ndërhyrjet e emergjencës, mbikëqyrjen dhe rigjenerimin e vijës bregdetare;
- synon gjithashtu të ndihmojë pushuesit duke vendosur cmime referuese për plazhet publike.

Ndikimi në administrimin e plazheve

Zbatimi i tarifës pritet të sigurojë:

- standard të qëndrueshëm të pastërtisë përgjatë gjithë sezonit;
- kontroll më të mirë të hapësirës publike;
- rritje të cilësisë së shërbimit për vizitorët;
- të ardhura të dedikuara për investime të reja në plazhe publike.

NDRYSHIMI 7 – TAKSA MBI KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË

Analiza e tregut të pronave

Vlerat e tregut janë rritur ndjeshëm për shkak të kërkesës turistike dhe investimeve të reja, por taksa ekzistuese nuk reflekton këto ndryshime.

Nevoja për harmonizim fiskal

- Fluks i rritur transaksionesh në shitblerje pronash të patundëshme;
- Mospërputhje mes vlerës reale dhe tatimore;
- Kosto shtesë për administrim dhe verifikime;
- Mungesë kontributi proporcional.

Arsyetimi i ndryshimit

Rritja e taksës balancion fitimet e subjekteve me përgjegjësinë e tyre fiskale. Masa siguron të ardhura reale për financim të investimeve publike dhe përputhet me kompetencat ligjore të Këshillit Bashkiak. Ajo garanton drejtësi dhe proporcionalitet në tregun e pronave.

Efektet e pritshme

- Rritje të të ardhurave;
- Më shumë fonde për investime;
- Balancim të barrës tatimore.

NDRYSHIMI 8 – TARIFA E GJELBËRIMIT DHE NDRIÇIMIT

Kosto reale të shërbimeve

Rritja e kostove të energjisë, materialeve dhe shërbimeve të mirëmbajtjes ka rritur ndjeshëm shpenzimet për ndriçim publik dhe gjelbërim por edhe nevojën për të ofruar një shërbim shumë më cilësor në këtë drejtim.

Mospërputhje me përdorimin real

3. Bizneset e mëdha konsumojnë ndriçim më të lartë;
4. Subjektet ndërtuese krijojnë kosto shtesë për territorin;
5. Tarifa ekzistuese nuk mbulon shpenzimet.

Arsyetimi i ndryshimit

Rritja e tarifës synon proporcionalitet midis përdorimit të infrastrukturës publike dhe kontributit financiar. Tarifa paraprake ishte nën kosto dhe nuk garantonte mbulimin e shërbimeve. Masa rrit cilësinë e ndriçimit dhe gjelbërimit në zonat turistike. Jane dy zërat që kanë performancën më të ulët financiare në vitin e shkuar.

Përfitimet urbane dhe territorial

- Investime më të mira në ndriçim bazuar edhe në kërkesat e rritura të komuniteteve gjatë dëgjësave publike për paketën fiskale dhe buxhetin 2026;
- Gjelbërim më i mirëmbajtur dhe i shtuar;
- Siguri publike dhe estetike më e lartë.

Analiza e projeksioneve për periudhën 2027–2029

Për vitin 2027, të ardhurat totale parashikohen në vlerën 8,245,810 lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 9.2% krahasuar me vitin 2026. Të ardhurat nga burimet e veta arrijnë në 6,868,730 lekë, duke përbërë rreth 83.3% të totalit të të ardhurave. Trashëgimia nga viti i shkuar reduktohet ndjeshëm në 1,000,000 lekë, ose rreth 12.1% të totalit. Për vitin 2028, të ardhurat totale parashikohen në vlerën 9,421,320 lekë, me një rritje prej rreth 14.3% krahasuar me vitin 2027. Të ardhurat nga burimet e veta rriten në 8,525,400 lekë, duke përbërë rreth 90.5% të totalit të të ardhurave, ndërsa trashëgimia nga viti i shkuar reduktohet në 500,000 lekë, ose vetëm 5.3%.

Për vitin 2029, të ardhurat totale parashikohen në masën 9,805,960 lekë, me një rritje të moderuar prej rreth 4.1% krahasuar me vitin 2028. Të ardhurat nga burimet e veta arrijnë në 9,049,960 lekë, duke përbërë mbi 92% të totalit të të ardhurave, ndërsa trashëgimia nga viti i shkuar reduktohet më tej në 350,000 lekë, ose rreth 3.6%.

Këto projeksione tregojnë një ndryshim thelbësor të strukturës fiskale të Bashkisë Himarë, me orientim të qartë drejt autonomisë financiare dhe uljes së varësisë nga burime jo të qëndrueshme.

Metodologjia e përdorur në hartimin e projeksioneve

Projeksionet e paraqitura janë ndërtuar mbi bazën e analizës së realizimeve faktike të viteve 2024–2025, tendencave të rritjes së vitit 2026, si dhe parashikimeve konservatore për transfertat nga buxheti i shtetit.

Për të ardhurat nga burimet e veta është aplikuar një skenar progresiv, i mbështetur në zgjerimin e bazës tatimore, formalizimin e ekonomisë lokale, rritjen e aktivitetit turistik dhe përmirësimin e eficiencës së administrimit fiskal vendor.

Metodologjia respekton parimet e planifikimit afatmesëm buxhetor, qëndrueshmërisë fiskale dhe përputhshmërisë me kapacitetet reale administrative të bashkisë.

Analiza e politikave fiskale të ndjekura

Politikat fiskale të reflektuara në këto projeksione synojnë forcimin e të ardhurave nga burimet e veta përmes rishikimit të taksave dhe tarifave vendore, përmirësimit të regjistrave fiskalë dhe rritjes së nivelit të mbledhjes së detyrimeve.

Gjithashtu, synohet ulja graduale e varësisë nga trashëgimia buxhetore, duke rritur disiplinën financiare dhe saktësinë e planifikimit të shpenzimeve.

Transferta e pakushtëzuar trajtohet si burim stabil mbështetës dhe jo si faktor nxitës i rritjes së buxhetit.

Analiza e risqeve dhe masat për menaxhimin e tyre

Rreziku kryesor i identifikuar lidhet me mundësinë e mbivlerësimit të të ardhurave nga burimet e veta, veçanërisht për vitin 2026, ku parashikohet një rritje shumë e lartë krahasuar me vitet paraardhëse.

Rreziqe të tjera përfshijnë sezonalitetin e aktivitetit ekonomik, kufizimet në kapacitetet administrative dhe ndryshimet e mundshme në kuadrin ligjor dhe fiskal kombëtar.

Masat parandaluese përfshijnë monitorimin periodik të realizimit buxhetor, rishikimin vjetor të projeksioneve, diversifikimin e burimeve të të ardhurave dhe krijimin e fondeve rezervë për përballimin e devijimeve të mundshme.

❖ Përfundime

Në përfundim, analiza tregon se Bashkia Himarë ndodhet në një proces të avancuar transformimi fiskal, duke kaluar nga një model financimi i bazuar kryesisht në fonde të trashëguara, drejt një modeli të qëndrueshëm të bazuar në të ardhurat nga burimet e veta, në përputhje me parimet e autonomisë financiare dhe zhvillimit të qëndrueshëm vendor.

Ky relacion paraqitet për shqyrtim, diskutim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak.

DREJTORI

Besa Xhaferi



BURIMET BUXHETORE		2024	2025	2026	2026	2027	2028	2029
		Fakti	Fakti	Buxh. Fillësuar	Prilëvizim	Plan	Plan	Plan
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	684,305	1,362,877	4,222,200	4,222,200	6,856,730	8,525,400	9,049,960
A.1	Të Ardhura nga Taksat Lokale	409,005	1,057,354	3,597,500	3,597,500	6,204,850	7,807,450	8,312,120
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	5,000	2,000	-	-	-	-	-
A.1.2	Taksa mbi pasuritë e paluajtshme	44,000	54,500	60,500	60,500	63,350	64,400	67,800
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	35,000	44,000	50,000	50,000	52,000	52,600	55,000
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	4,500	4,500	4,500	4,500	4,850	5,000	5,600
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	4,500	6,000	6,000	6,000	6,500	6,800	7,200
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	-	-	-	-	-	-	-
A.1.3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	20,000	22,000	30,000	30,000	33,000	33,500	34,000
A.1.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	338,505	873,354	3,500,000	3,500,000	6,100,000	7,700,000	8,300,000
A.1.5	Taksa e tabelës	-	-	500	500	1,000	1,500	2,000
A.1.6	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llog. Vend.	-	-	-	-	-	-	-
A.1.7	Taksa e përkohësme	-	4,000	4,000	4,000	4,500	4,850	5,000
A.1.8	Taksa e përkohësme 1	1,500	1,500	2,500	2,500	3,000	3,200	3,320
A.1.9	Taksa e përkohësme 2	-	-	-	-	-	-	-
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	18,800	37,000	39,700	39,700	43,720	44,900	46,220
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasurisë e paluajtshme	10,000	27,000	30,000	30,000	32,000	32,500	33,000
A.2.2	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	3,500	4,500	5,000	5,000	5,500	5,800	6,320
A.2.3	Taksa e rentës minierare	1,500	3,000	1,200	1,200	1,320	1,400	1,600
A.2.4	Taksa mbi të ardhurat personale	3,800	4,500	3,500	3,500	4,500	5,200	5,300
A.2.5	Taksa të tjera	-	-	-	-	-	-	-
A.3	Të Ardhurat nga Tarifat Vendore	243,500	254,023	563,000	563,000	595,660	645,310	663,320
A.3.1	Tarifa me menaxhimin e mbetjeve	90,000	90,000	120,000	120,000	122,900	125,250	126,100
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	14,000	14,900	16,000	16,000	16,500	17,300	17,500
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	16,000	15,800	17,000	17,000	17,400	18,250	18,900
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	60,000	59,300	87,000	87,000	89,000	89,700	90,100
A.3.2	Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve	-	-	-	-	-	-	-
A.3.3	Tarifa për ndriçimin publik	10,000	11,000	11,000	11,000	12,270	13,020	13,520
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	1,000	950	950	950	1,200	1,400	1,520
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	2,000	2,000	2,000	2,000	2,200	2,320	2,500
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	7,000	8,050	8,050	8,050	8,870	9,300	9,500
A.3.4	Tarifa për gjelbërimin	10,000	11,000	11,000	11,000	12,270	12,820	13,400
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	1,000	950	950	950	1,200	1,200	1,400
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga institucionet	2,000	2,000	2,000	2,000	2,200	2,320	2,500
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	7,000	8,050	8,050	8,050	8,870	9,300	9,500
A.3.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	120,500	117,023	216,000	216,000	233,220	264,220	274,800
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	2,000	8,000	8,000	8,000	8,820	9,260	9,500
A.3.5.2	Tarifa për dhënie të licencave, lejeve e autorizimeve	500	1,000	5,000	5,000	1,100	1,160	1,200
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.4	Tarifa për vullgoje veterinare të bagëti të thurura	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.5	Tarifa e licencimit të veprimtarive të transportit	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjete të licencuara dhe vendparkime publike	3,000	8,023	3,000	3,000	3,300	3,800	4,100
A.3.5.7	Tarifa për dhënie të licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.8	Tarifa për pyje dhe kullotat	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesa nga zjarrehiqja	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.10	Tarifa për zënim dhe përdorimin e hapësirës publike dhe fasadave	115,000	100,000	200,000	200,000	220,000	250,000	260,000
A.3.5.11	Tarifa për trajtimin e mbetjeve Inerte në landfille	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.12	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energi, TV Kablor, Internet)	-	-	-	-	-	-	-
A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6	Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.1	Biblioteka	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.2	Muzeumet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.3	Teatri	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.5	Pallati i sportit	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.6	Qendra Komunitare	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.7	Mensa (Konvikti)	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.8	Kopshitet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.6.9	Çerdhet	-	-	-	-	-	-	-
A.3.7	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	1,000	-	-	-	-	-	-
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujtes dhe kullimit	-	-	-	-	-	-	-
A.3.9	Tarifa e përkohësme	12,000	25,000	205,000	205,000	215,000	230,000	235,500
A.3.10	Tarifa të tjera	13,000	17,500	22,000	22,000	24,500	27,740	28,300
A.4	Të Ardhurat e Tjera	10,000	10,000	10,000	10,000	12,000	14,520	14,700
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	-	-	-	-	-	-	-
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale	-	-	-	-	-	-	-
A.4.3	Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të bashkisë	-	-	-	-	-	-	-
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat	-	-	-	-	-	-	-
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	-	-	-	-	-	-	-
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	-	-	-	-	-	-	-
A.4.7	Kundërveprimet administrative (Gjobat)	3,000	7,500	12,000	12,000	12,500	13,220	13,600
A.4.8	Sekuestime dhe Zhdëmtime	-	-	-	-	-	-	-
A.4.9	Kuotat e anëtarësive së bashkëve	-	-	-	-	-	-	-
A.4.10	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	-	-	-	-	-	-
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	-	-	-	-	-	-	-
A.4.12	Shitja e aseteve financiare	-	-	-	-	-	-	-
A.4.13	Shitja e aseteve fikse të preksme / paprekshme	-	-	-	-	-	-	-
A.4.14	Të tjera	-	-	-	-	-	-	-
B	Transferta nga Buxheti Qendror	280,412	306,109	342,096	342,096	377,080	395,920	406,000
B.1	Transferta e Pakushtëzuar	159,741	205,509	221,935	221,935	244,680	256,920	265,000
B.2	Transferta e Kushtëzuar	53,897	-	39,100	39,100	43,100	45,200	46,000
B.2.1	Për funksionet e deleguara	-	-	-	-	-	-	-
B.2.2	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	53,897	-	39,100	39,100	43,100	45,200	46,000
B.3	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	66,774	100,600	81,061	81,061	89,300	93,800	95,000
C	Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
C.1	Huamarrja Afatshkurtër	-	-	-	-	-	-	-
C.2	Huamarrja Afatgjatë	-	-	-	-	-	-	-
D	Trashëgimi nga Viti i Shkuar	1,077,720	1,481,226	2,988,419	2,988,419	1,000,000	500,000	350,000
D.1	Trashëgimi Pa Destinacion	1,077,720	1,481,226	2,988,419	2,988,419	1,000,000	500,000	350,000
D.2	Trashëgimi Me Destinacion	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË		2,042,437	3,153,212	7,552,715	7,552,715	8,245,810	9,421,320	9,805,960